

LETËR PËR MOSMIRATIM

(PËR PRINDËRIT E NXËNËSVE/EVE NGA KLASA E NËNTË DERI NË KLASËN E DYMBËDHJETË, SI EDHE PËR NXËNËSIT/ET E SHKOLLËS SË MESME, MOSHA MBI 18 VJEÇ)

Ligji federal kërkon që Departamenti i Arsimit i Qytetit të Nju Jorkut (DOE) t’u vënë në dispozicion rekrutuesve ushtarakë dhe institucioneve të arsimit të lartë informacionin e mëposhtëm për nxënësit/et e klasës së 11-të dhe të 12-të të shkollës së mesme, kur ata e kërkojnë këtë informacion, përveç rasteve kur prindi i një nxënësi/eje nën moshën 18 vjeç, ose nëse ai/ajo është 18 vjeç ose më shumë, zgjedh të mos japë miratim duke njoftuar me shkrim DOE-n se nuk pranon shpërndarjen e këtij informacioni. Nëse nxënësi/ja është nën moshën 18 vjeçare, është prindi ai që duhet të nënshkruajë letrën e mosmiratimit. Nëse nxënësi/ja është 18 vjeç ose më shumë, është nxënësi/ja që duhet të nënshkruajë letrën e mosmiratimit.

- emri, adresa dhe numri i telefonit, për t’u vënë në dispozicion të institucioneve të arsimit të lartë që e kërkojnë këtë informacion dhe/ose;
- emri, adresa, numri i telefonit dhe adresa elektronike e nxënësit/es e siguruar nga DOE për t’u vënë në dispozicion të rekrutuesve ushtarakë që e kërkojnë këtë informacion. *(Ju lutemi vini re se çdo e-mail i dërguar nga rekrutuesit ushtarakë në adresat elektronike DOE të nxënësve/eve, nuk kontrollohet, sponsorizohet apo rishikohet nga DOE.)*

Ndërsa jemi të përkushtuar për të mbrojtur konfidencialitetin e nxënësve dhe nxënësve tona, ne kemi dhe detyrimin ndaj ligjit.

Nëse jeni prindi i një fëmije nën moshën 18 vjeç dhe nuk jepni miratimin për shpërndarjen e këtij informacioni , duhet të plotësoni, nënshkruani dhe dorëzoni këtë formular në shkollën e fëmijës suaj ***brenda datës 22 tetor, 2025***. Nëse nuk e dorëzoni formularin brenda kësaj date dhe fëmija juaj është nxënës/e në klasën e 11-të ose të 12-të, ne do të ndajmë informacionin e fëmijës suaj sipas kërkesës. Për prindërit e nxënësve/eve të klasës së 9-të dhe të 10-të, formulari i mosmiratimit mund të plotësohet dhe ruhet paraprakisht.

Nëse jeni nxënës/e me moshë 18 vjeç ose më shumë, ju duhet të vendosni vetë nëse pranoni që informacioni juaj të ndahet apo jo. Nxënësit/et e moshës 18 vjeç ose më shumë, të cilët nuk duan që informacioni i tyre të ndahet, duhet të plotësojnë, nënshkruajnë dhe dorëzojnë këtë formular në shkollën e tyre ***brenda datës 22 tetor, 2025***. Nëse letra e mosmiratimit nuk dërgohet, informacioni i nxënësit/es do të shpërndahet sipas kërkesës.

Prindërit e nxënësve/eve, nën moshën 18 vjeç dhe nxënësit/et 18 vjeç ose më shumë, të cilët nuk plotësojnë formularin tani, mund ta bëjnë këtë kurdo, për sa kohë që nxënësi/ja është i/e regjistruar në një shkollë të DOE-s. Për më shumë informacion ose ndihmë, ju lutemi kontaktoni shkollën tuaj. Faleminderit për bashkëpunimin tuaj.

FORMULAR PËR MOSMIRATIM

Ju lutemi plotësoni dhe nënshkruani më poshtë, vetëm në rast se nuk dëshironi që informacioni i përshkruar më sipër të ndahet me rekrutuesit ushtarakë dhe/ose institucionet e arsimit të lartë. Nuk keni nevojë ta plotësoni këtë formular nëse nuk dëshironi të kufizoni shpërndarjen e informacionit.

Emri i Nxënësit/es: _____ Klasa Zyrtare e Nxënësit/es: _____

Emri i Shkollës: _____

Nëse nxënësi/ja është më i vogël se 18 vjeç:

- ☐ Unë jam prindi i nxënësit/es së mësipërme, i cili është nën moshën 18 vjeçare.

Ju lutem të përzgjidhni kutinë përkatëse:

- ☐ ***Rekrutuesit Ushtarakë:*** Unë nuk dëshiroj që emri, adresa, numri i telefonit dhe adresa elektronike DOE e fëmijës tim të ndahen me rekrutuesit ushtarakë.
- ☐ ***Institucionet e Arsimit të Lartë:*** Unë nuk dëshiroj që emri, adresa dhe numri i telefonit të fëmijës tim të ndahet me institucionet e arsimit të lartë.
- ☐ ***Të dyja institucionet:*** Unë nuk dëshiroj që informacioni i fëmijës tim të ndahet, as me rekrutuesit ushtarakë dhe as me institucionet e arsimit të lartë.

Emri i Prindit: _____

Nënshkrimi i Prindit: _____ Data: _____

Nëse nxënësi/ja është 18 ose mbi 18 vjeç:

- ☐ Unë jam nxënësi/ja e përmendur më sipër dhe jam 18 vjeç ose më shumë.

Ju lutem të përzgjidhni kutinë përkatëse:

- ☐ ***Rekrutuesit Ushtarakë:*** Unë nuk dëshiroj që emri, adresa, numri i telefonit dhe adresa elektronike DOE e nxënësit/es të ndahen me rekrutuesit ushtarakë.
- ☐ ***Institucionet e Arsimit të Lartë:*** Unë nuk dëshiroj që emri, adresa dhe numri im i telefonit të ndahet me institucionet e arsimit të lartë.
- ☐ ***Të dyja institucionet:*** Unë nuk dëshiroj që informacioni im të ndahet, as me rekrutuesit ushtarakë dhe as me institucionet e arsimit të lartë.

Emri i Nxënësit/es: _____

Nënshkrimi i Nxënësit/es: _____ Data: _____